

UDHËZIM
Nr.7, datë 25.2.2010

**PËR PËRFUNDIMIN E VITIT SHKOLLOR 2009-2010 DHE PËR ZHVILLIMIN E
PROVIMEVE TË LIRIMIT NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
PËRFUNDIMI I KLASËS IX TË ARSIMIT BAZË

1. Viti mësimor 2009–2010, për klasën e IX të arsimit bazë, të përfundojë në datën 1 qershor 2010 dhe të llogaritet me 34 javë mësimore.

2. Provimet e liritimit për klasën IX të zhvillohen më:

- | | |
|-----------------|------------------|
| a) Gjuhë shqipe | 7 qershor 2010, |
| b) Matematikë | 19 qershor 2010. |

KREU II
DATAT PËR SESIONIN E DYTË TË PROVIMEVE TË LIRIMIT

1. Lëndët dhe datat e provimeve të liritimit në sesionin e dytë për nxënësit mbetës janë:

- | | |
|----------------------------------|-----------------|
| a) Gjuhë shqipe dhe lexim letrar | 1 shtator 2010, |
| b) Matematikë | 6 shtator 2010. |

KREU III
MASA PËR MBARËVAJTJEN E PROVIMEVE

1. Drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe drejtoritë e shkollave të marrin të gjitha masat që viti mësimor 2009-2010, për klasat e nënta, të mbyllet sipas programit dhe me nota përfundimtare për çdo lëndë brenda datës 2 qershor 2010, duke shfrytëzuar orët në dispozicion.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr.31, datë 31.8. 2009 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2009-2010”, në lidhje me përfundimin e vitit shkollor 2009-2010, për klasat e 9 të arsimit bazë dhe në lidhje me zhvillimin e provimeve të liritimit për sesionin e parë, revokohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri që mbulon arsimin parauniversitar, sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj